

KONTRATE SHITBLERJE E PASURISE LUAJTSHME

(SHITJE KUOTASH)

Sot me date 09/11/2021 lidhet kjo kontrate shitje mes paleve si me poshte:
PALA SHITSE:

1.YASIR ABAKER ABDELMOULA AHMED, shtetas sudanez, i datëlindjes 26.10.1969 lindur në Sudan dhe banues në Tirane, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr identifikimi **P07235201**, (me poshte referuar si "Shitesi"),

PALA BLERESE:

1MOHAMED MOHAMED HASSAN ELSHARKAWY, shtetas egjyptian, i datëlindjes 18.03.1960 lindur në Egjypt dhe banues në Tirane, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr identifikimi **A04207940**, (me poshte referuar si "Blerësi")

2GAMAL ABDELNASSER AHMED ABDELGALIL, shtetas egjyptian, i datëlindjes 01.06.1962 lindur në egjypt dhe banues në Tirane, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr identifikimi **A23120283**, (me poshte referuar si "Blerësi")

Ne vijim e per efekt te kesaj Kontrate, Shitesit dhe Blerësi do te referohen vecmas si Pale/a dhe se bashku si Pale/t.

MEQENESE:

Shitesi i ka njoftuar Bleresit oferten e tyre per shitjen e 20% të kapitalit te Shoqerise qe ai zoteron dhe Bleresit kane pranuar te blejne pjesmarrjen e ofruar nga Shitesi ne Shoqeri;

Shoqeria "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" Sh.p.k. (ne vijim "Shoqeria") eshte nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit me Numer Unik Identifikimi NUIS M12107012J, me Kapital themeltar prej 100.000 leke te ndara ne 3 kuota dhe sikurse rezulton nga regjistrimet ne Regjistrin Tregtar, Shitesi **YASIR ABAKER ABDELMOULA AHMED** zoteron 1 kuote me 20% te pjesemarrjes ne Kapital,

Palet kane vendosur te lidhin kete Kontrate sa me poshte vijon:

Neni 1. Objekti

1.1.Nepermjet kesaj Kontrate Shitesi **YASIR ABAKER ABDELMOULA AHMED** u shet **100%** te kuotes se kapitalit qe ai zoteron ne Shoqerine "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" Sh.p.k. bleresve, nga te cilat **50% MOHAMED MOHAMED HASSAN ELSHARKAWY** dhe **50% GAMAL ABDELNASSER AHMED ABDELGALIL**.

Neni 2. Cmimi

2.1 Cmimi i shitjes se 20% kuotave te kapitalit nga ortakut **YASIR ABAKER**

ABDELMOULA AHMED është ne vleren 20.000 leke, e cila do të paguhet menjëherë nga bleresi **MOHAMED MOHAMED HASSAN ELSHARKAWY** ne vleren 10.000 leke dhe **GAMAL ABDELNASSER AHMED ABDELGALI** ne vleren 10.000 leke.

Neni 3. Deklarimet dhe garancitë

3.1. Shitesi deklaron dhe verteton se ne datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate zoteron pjesëmarrjen e transferuar sipas kësaj Kontrate. dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave janë të Shitesit

3.2. Bleresi deklaron dhe verteton se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Bleresi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Bleresi.

Neni 4. Transferimi i të drejtave

4.1 Pronesia mbi kuotat e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitesit të Bleresi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe regjistrimit në QKB të vendimit të Asamblesë së Shoqërisë "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" Sh.p.k dhe pavarësisht mënyrës së pagesës së cmimit të shitjes. Kjo Kontrate nuk është dhe në asnjë rast nuk do të interpretohet si një kontratë shitje me rezerve pronësie. Kalimi i pronësive së kuotave të Shoqërisë në favor të Bleresve do të regjistrohet menjëherë në Qendër Kombëtare të Bimësive, pas miratimit nga asambleja e ortakeve të këtij transferimi, në përputhje me Ligjin 9901/2008, të ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, të ndryshuar.

4.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Bleresi gezon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuotat në Regjistrin Tregtar si dhe pranë çdo institucioni tjetër sipas legjislativës në fuqi.

Neni 5. Të ndryshme

5.1 Cdo kusht, klauzole apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzolave apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të cenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.

5.2 Kjo Kontrate do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, të ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

5.3 Cdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontrate do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Paleve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Kjo Kontrate hartohet në gjuhën shqipe në 2 (dy) kopje origjinale.

PALET KONTRAKTUESE


Lexuar, aprovuar dhe nenshkuar nga:

Bleresi

MOHAMED MOHAMED HASSAN ELSHARKAWY



GAMAL ABDELNASSER AHMED ABDELGALIL



Shitesi

YASIR ABAKER ABDELMOULA AHMED

